

Newsletter

Autoriteti i Konkurrencës gjatë muajve Janar-Mars 2025 ka marrë 25 vendime:

- **Përqendrime:** 13 vendime;
- **Vendime me gjobë:** 1 vendim;
- **Abuzim me pozitën dominuese:** 5 vendime;
- **Vendime të tjera:** 6 vendime.



Ndër vendimet më të rëndësishme mund të përmendim:

1 Hapje hetimi të thelluar

Autoriteti i Konkurrencës vendos nën hetim të thelluar Bankat e Nivelit të Dytë

Autoriteti i Konkurrencës hap procedurën e hetimit të thelluar në tregun e ndërmjetësimit për sigurimin e jetës për kreditë të cilat kërkojnë sigurim jete për ndërmarrjet: OTP Bank Albania SHA, Banka Kombëtare Tregtare SHA, Credins Bank SHA, Banka Raiffeisen SHA, Banka e Tiranës SHA, Intesa SanPaolo Bank Albania SHA, Union Bank SHA, E-Business Solutions SHPK, Banka e Bashkuar e Shqipërisë SHA, Banka Amerikane e Investimeve SHA dhe Abi Broker Sigurimesh SHA dhe në tregun e kredidhënies me sigurim jete për kreditë që jepen brenda bankës Bankës së Parë të Investimeve SHA dhe Bankës Procredit SHA.

Komisioni i Konkurrencës në mbledhjen e tij, datë 26.03.2025, në vlerësim të të dhënave të marra gjatë fazës së hetimit paraprak në tregun e sigurimit të jetës për kredi, konkludoi se sjellja e ndërmarrjeve Banka Raiffeisen SHA, OTP Bank Albania SHA, Banka Kombëtare Tregtare SHA, Tirana Bank SHA, Intesa SanPaolo Bank Albania SHA, Union Bank SHA, E-Business Solutions SHPK, ABI Bank SHA, Abi Broker Sigurimesh SHA dhe Procredit Bank SHA mund të përbëjë shkelje të nenit 4 dhe nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003 ndërkohë që sjellja e ndërmarrjeve Tirana Bank SHA, Credins Bank SHA, Banka e Bashkuar e Shqipërisë SHA dhe Banka e Parë e Investimeve SHA mund të përbëjë shkelje të nenit 9 të Ligjit nr. 9121/2003.

Për këto arsye, **me vendimin nr. 1171, datë 26.03.2025**, u vendos hapja e procedurës së hetimit të thelluar.

Hetimi i thelluar përfshin periudhën kohore nga 07.11.2021 deri në 26.03.2025.

2 Përqendrime

Komisioni i Konkurrencës, në mbledhjen e tij më datë 14.01.2025, mori në shqyrtim 2 njoftime përqendrime:

- Përqendrimi i propozuar për krijimin e një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, nga shoqëritë Daimler Truck AG dhe Aktiebolaget Volvo.
- Përqendrimi i realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Diaverum AB nga shoqëria M42 LTD.

Transaksionet nuk do të krijojnë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar, nuk shfaqin shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese dhe nuk do të sjellin ndryshim apo do të kenë ndikim në tregun shqiptar.

Për këto arsye, Komisioni i Konkurrencës vendosi:

- 1.Me Vendimin nr. 1148, datë 01.2025, të autorizojë përqendrimin e propozuar për krijimin e një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota, nga shoqëritë Daimler Truck AG dhe Aktiebolaget Volvo.
- 2.Me Vendimin nr. 1149, datë 01.2025, të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Diaverum AB nga shoqëria M42 LTD.

Gjithashtu, Komisioni i Konkurrencës, në mbledhjen e tij më datë 29.01.2025, mori në shqyrtim 2 njoftime përqendrime:

- Përqendrimi i realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë STEFANI & CO SHA nga shoqëria Eurolab Internacional Grup SHPK.
- Përqendrimi nëpërmjet përfutimit të kontrollit të vetëm indirekt nga shoqëria Dr. Ing.h.c.F. Porsche Aktiengesellschaft mbi biznesin dhe asetet që përfshijnë bizneset franchised të tregtimit të motorëve të drejtura nga STRATSTONE SPECIALIST CARS LTD.

Pas shqyrtimit të raportit të Sekretariatit të Konkurrencës, Komisioni i Konkurrencës vendosi:

- 1.Me Vendimin nr. 1154, datë 01.2025, të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë STEFANI & CO SHA nga shoqëria Eurolab Internacional Grup SHPK.
- 2.Me Vendimin nr. 1155, datë 01.2025, të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të vetëm indirekt nga shoqëria Dr. Ing.h.c.F. Porsche Aktiengesellschaft mbi biznesin dhe asetet që përfshijnë bizneset franchised të tregtimit të motorëve të drejtura nga STRATSTONE SPECIALIST CARS LTD.



Aktivite



“Mbrojtja e konsumatorëve, nxitja e konkurrencës: perspektiva dhe strategji për tregjet gjithëpërfshirëse dhe dixhitale” ishte tema e Forumit Ndërkombëtar të organizuar sot nga Autoriteti i Konkurrencës dhe Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorit, si pjesë e projektit të bashkëpunimit teknik të UNCTAD.

Forumi mbledhi së bashku ekspertë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, përfaqësues të institucioneve publike dhe private, si dhe aktorë të tjerë të interesuar, me fokus ndërthurjen e politikave të konkurrencës dhe mbrojtjes së konsumatorit në ekonominë dixhitale në zhvillim.

Pas fjalës së hapjes nga z. Denar Biba, Kryetar i Autoritetit të Konkurrencës, znj. Borana Kalemi, Këshilltare pranë Ministrisë së Ekonomisë, dhe znj. Teresa Moreira, Drejtuese e Degës për Politikën e Konkurrencës dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të UNCTAD, aktiviteti vijoi me nënshkrimin e një Memorandumi Mirëkuptimi ndërmjet Autoritetit të Konkurrencës dhe Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorit.

Programi përfshiu dy panele diskutimi:

- Paneli i parë u fokusua në integrimin e perspektivave të konkurrencës dhe mbrojtjes së konsumatorit për tregjet gjithëpërfshirëse.
- Paneli i dytë trajtoi sfidat dhe mundësitë e zbatimit të ligjit në tregjet dixhitale, duke eksploruar opsionet e politikave për të garantuar konkurrencë të drejtë dhe mbrojtje të drejtave të konsumatorëve.

Pjesëmarrësit ndanë praktikën më të mira dhe propozuan strategji për të adresuar sfidat komplekse të tregjeve bashkëkohore, duke u përqendruar në përf forcimin e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve relevante.

Forumi u mbyll me një sesion përmbledhës, ku z. Denar Biba përmbylli diskutimet duke theksuar rëndësinë e vazhdimin e qasjeve të integruara dhe bashkëpunimit për një zhvillim të qëndrueshëm të tregut shqiptar.

Ky aktivitet shënon një hap të rëndësishëm drejt krijimit të një kulture më të fuqishme të konkurrencës dhe mbrojtjes së konsumatorëve në Shqipëri.

